

VENDIM
Nr. 101, datë 9.4.2026

**MBI HEQJEN E LICENCËS SË SHOQËRISË “ENERGY MARKET ALBANIA”
SHPK NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE DHËNË
ME VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 138, DATË 14.4.2023**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 42, pika 1, germa “ç”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të neneve 5, germa “ç”; 9, germa “c”, të “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 58, datë 18.4.2017; të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; si dhe të pikës 5.1, germa “ç”, të “Kushteve të licencës për tregtimin e energjisë elektrike” miratuar me vendimin e Bordit të ERE nr. 97, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 9.4.2026, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 611/1 prot., datë 8.4.2026, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës, Drejtoria Juridike dhe e Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve dhe Drejtoria Ekonomike dhe e Financës, “Mbi heqjen e licencës për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “Energy Market Albania” sh.p.k.”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 31, datë 4.2.2026, ka vendosur të fillojë procedurën për heqjen e licencës nr. 555, seria T23, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “Energy Market Albania” sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 138, datë 14.4.2023.

- Ky vendim u mor për shkak se shoqëria nuk kishte shlyer në afat pagesën rregullatore të vitit 2025 ndaj ERE-s, duke rezultuar debitore për këtë pagesë, si dhe nuk ka përcjellë në ERE sqarime/dokumentacion mbi mosshlyerjen e detyrimit.

- ERE ka njoftuar shoqërinë për vendimmarrjen e mësipërme me shkresën nr. 611 prot., datë 16.2.2026. Në të njëjtën ditë, një kopje e skanuar e kësaj shkrese i është dërguar shoqërisë dhe me postë elektronike. Këto njoftime konsiderohen të marra nga shoqëria, për sa kohë nuk rezulton kthimi i tyre. Po ashtu, janë kryer disa tentativa kontakti në numrin e telefonit të disponuar nga ERE, por nuk është marrë asnjë përgjigje nga ana e shoqërisë.

- Në referencë të përcaktimeve të nenit 7, germa “b”, të “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave të të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, të licencuarit kanë të drejtën për t’u përgjigjur me shkrim brenda 30 ditëve nga data e marrjes së këtij njoftimi.

- Vendimi i Bordit të ERE-s nr. 31, datë 4.2.2026, është publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 42, datë 23.2.2025, ndaj dhe llogaritja e afatit 30-ditor vlerësohet të fillojë nga kjo datë.

- Në nenin 42, pika 1, germa “ç”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, të nenin 5, germa “ç”, të “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.4.2017, si dhe në pikën 5.1, germa “ç”, të “Kushteve të licencës për tregtimin e energjisë elektrike”, parashikohet se: “ERE heq një licencë kur i licencuari nuk kryen pagesat e rregullimit, të vendosura nga ERE.”.

- Duke qenë se, në përfundim të afatit 30-ditor (23.3.2026), duke e përllogaritur këtë afat nga botimi i vendimit në Fletoren Zyrtare, ka rezultuar se shoqëria nuk ka shlyer pagesën e rregullimit e po ashtu nuk ka përcjellë në ERE as shpjegime dhe as dokumentacion për sa kërkuar, si dhe nuk ka bërë përpjekje për të shmangur shkakun ligjor që çoi ERE-n në fillimin e procedurës për marrjen e masës administrative për heqjen e licencës së saj, vlerësohet të vijohet me heqjen e licencës nr. 555, seria T23, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “Energy Market Albania” sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 138, datë 14.4.2023.

- Me heqjen e kësaj licence, shoqëria “Energy Market Albania” sh.p.k. nuk mban më statusin e të licencuarit nga ERE dhe nuk mund të ushtrojë më veprimtarinë për të cilën ishte licencuar.

- Pavarësisht vendimit për heqjen e licencës, shoqëria nuk çlirohet nga detyrimi për të shlyer debinë përkatëse për vitin 2025, si dhe pagesën rregullatore të vitit 2026 (miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 63, datë 26.2.2026), detyrim ky që i ka lindur shoqërisë ndërkohë që ishte e licencuar nga ERE. Vjelja e këtyre detyrimeve do të bëhet me rrugë gjyqësore, sipas procedurave ligjore në fuqi.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të heqë licencën nr. 555, seria T23, dhënë shoqërisë “Energy Market Albania” sh.p.k. për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 138, datë 14.4.2023.

2. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, licenca nr. 555, seria T23, bëhet e pavlefshme.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës të njoftojë shoqërinë “Energy Market Albania” sh.p.k., “OST” sh.a. dhe “ALPEX” sh.a. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti